



23-07-2018

Më  
ana

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:011427  
Datë: 27.04.2018  
Numri i dokumentit: 00031081

P.nr.2837/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal gjyqtari, Mustaf Tahiri, me procesmbajtësen Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga komuna e Suharekës, i akuzuar për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj të evidentuar si: PP/II.nr.1302-1/17, të datës 09 nëntor 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më 17 prill 2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja dhe të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] mbiemri i vajzërisës së nënës [REDACTED] me vendbanim në rr. [REDACTED], komuna Suharekë, i pa martuar, punëtor, ka të kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 09 qershor 2017, rreth orës 02:40 në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, afër '██████████', Ferizaj, i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotikë, ashtu që policia me rastin e kontrollimit të veturës marka 'Mercedes', ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ██████████ FL, te pasagjeri tani i pandehuri, kishin gjetur një substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë, pas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka rezultuar se substanca narkotike është Kanabis(Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol me peshë prej 0,97 gram,

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4,7,17,21, 41,42,43,46, dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së; të akuzuarin e :

## **G J Y K O N**

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguaj pesëmbëdhjetë (15) ditë pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nenin 46 paragrafi 3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim burgimi, ashtu që për çdo njëzet (20) euro, do ti llogaritet një (1) ditë burg.

Sipas dispozitë së nenit 275 paragrafi 3 të KPRK-së, konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 0,97 gram.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej njëzet (20) € si dhe shumën prej tridhjetë (30) € për programin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, sipas aktakuzën së evidentuar si: PP/II.nr.1302-1/17, të datës 09 nëntor 2017, të akuzuarin, [REDAKTUAR] me vendbanim rr. [REDAKTUAR], komuna Suharekë, e ka ngarkuar për kryerjen e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale, më 18 prill 2018, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin Prokurori i Shtetit Mimoza Sylja, mbeti në tërësi pranë aktakuzës, si më lartë, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të dënohet konform ligjit.

Gjyqtari individual konform nenit 245, 246 dhe 248 të KPPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, ka njoftuar të akuzuarin, për të drejtat e tij lidhur me pranimin e fajësisë apo me mundësinë që të deklarohet i pafajshëm. I akuzuari me këtë rast ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se ai asnjëherë nuk ka përdorur substanca narkotike dhe se ka qenë nën ndikim të alkoolit është hera e parë që të ketë kryer këtë vepër penale, duke i premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

Prokurori i shtetit lidhur me marrjen e mendimit për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së pasi që është konform nenit 248 të KPRK-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim dhe të pranohet fajësia.

Mbrojtësi i të pandehurit [REDAKTUAR] av [REDAKTUAR] lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, ka deklaruar se pranimin i fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij i ka kuptuar veprimet e tij, ka pranuar fajësinë, është përndarë për veprimet e tij, dhe i premtonte gjykatës që më nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Gjykata konstaton se me që i pandehuri ka pranuar fajësinë, janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 248 paragrafi 1 të KPPRK-së se: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; pranimi është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij me autorizim av. [REDAKTUAR], pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në të gjitha provat e tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i datës 09.06.2017, raporti i ekspertimit me numër AKF/2017-

2460/2017-2216 i datës 20.10.2017, si dhe fotografitë që gjinden në shkresat e lëndës, duke përfshirë edhe faktin se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 paragrafi 1 të KPPRK-së, gjyqtari individual vlerëson se janë vërtetuar të gjitha faktet, dhe në bazë të dispozitës së paragrafit 4 të nenit 248 të KPPRK-së, me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, siç përshkruhet në datë, kohë dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit mori pranimin e fajësisë, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë veprë penale, si dhe faktin se i akuzuari është i moshës së re, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, të akuzuarit i vërtetoi dënimin me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro, me bindjen se në rastin konkret përmes shpalljes së dënimit me gjobë do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Gjithashtu gjykata ka vendosur që nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nenin 46 paragrafi 3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim burgimi, ashtu që për çdo njëzet (20) euro, do ti llogaritet një (1) ditë burg.

Konform nenit 275 paragrafi 3 të KPRK-së, është konfiskuar substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 0.97 gram, pasi që kjo sasi ka qenë objekt i veprës penale, të cilën e pa poseduar i akuzuari.

I akuzuari është obliguar konform nenit 450 të KPP-së që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej njëzetë (20) € dhe konform nenit 39 par.3 pika 3.1 të ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, taksën në shumë prej tridhjetë (30) €, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Nga arsyet e lartë shënuara, është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.2837/17, më 26 prill 2018**

**Sek. Juridike,**

Drita Ujupi

**Gjyqtari,**

Mustaf Tahiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.